



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**Kryeministri**

**VENDIM**

**Nr. 128 datë 14.03.2004**  
**Për**

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 459. DATË 23.09.1999, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETEROR PER KULTET”**

Në mbështetje të neneve 10 e 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të neneve 124 e 128, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI**

Në vendimin nr. 459, datë 23.09.1999 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet për të ndihmuar në krijimin , ndryshimin dhe shuarjen e marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare, që kanë objekt dhe ndjekin qëllime besimi dhe ndërgjegje, sipa ligjit në Republikën e Shqipërisë

Komiteti Shtetëror i Kulteteve është institucion qendror, person juridik në varësi të Kryeministrit.”

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Komiteti Shtetëror për Kultet përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë. Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet dhe anëtarët e këtij komiteti, të cilët propozohen nga kryetari, emërohen nga Kryeministri. Gjatë emërimit të përbërjes së Komitetit Shtetëror për Kultet, Kryeministri dhe kryetari i tij marrin parasysh dhe ruajnë parimet e asnjësisë shtetërore dhe të barazisë së bashkësive fetare, si dhe faktin, që struktura e komitetit, të reflektojë, realisht, identitetin dhe vlerat e bashkësive fetare.

Struktura, organika dhe rregullorja e veprimtarisë së Komitetit Shtetëror për Kultet miratohen nga Kryeministri, me propoziminin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Pagat e nëpunësve të Komitetit Shtetëror për Kultet të jenë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, ndërsa punonjësit e tjerë të paguhen sipas lidhjes II-5, të vendimit nr. 726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punojësve të institucioneve buxhetorë”, të ndryshuar”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**FATOS NANO**

**Lidhja nr. 1**

Emërtimi	Paga individuale (paga bazë)			Pagat Mujore
	1	2	3	Shtesa e Pozicionit
	Paga e grupit (PG)	Shtesa Vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për pozicion (SHP)
<b>Kryetar</b>	<b>9,000</b>	<b>2%</b>	<b>0</b>	<b>90,000</b>
<b>Antar</b>	<b>9,000</b>	<b>2%</b>	<b>0</b>	<b>90,000</b>
<b>Specialist</b>	<b>9,000</b>	<b>2%</b>	<b>0</b>	<b>20,000</b>